



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
 AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT  
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE  
 ANTI-CORRUPTION AGENCY


Dep. DPK  
 Dep. \_\_\_\_\_  
 Dep. \_\_\_\_\_

Nr. l faq. \_\_\_\_\_  
 Broj stranica 03  
 Nr. pages \_\_\_\_\_

Nr Prot \_\_\_\_\_  
 Bi Prot \_\_\_\_\_  
 Prot No. 03-02/1032/16

Data \_\_\_\_\_  
 Datum 11.03.2016  
 Date \_\_\_\_\_

PRISHTINE



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

<b>DATË/A:</b>	11.03.2016
<b>REFERENC-Ë:</b>	AKK-DPK-981/16
<b>PËR/ZA/TO:</b>	z. Muhamet Mustafa, Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës
<b>PËRMES/PREKO/THROUGH:</b>	
<b>NGA/OD/FROM:</b>	Hasan Preteni, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	Opinion lidhur me ofrimin e këshillimit profesional për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik

I nderuari z. Mustafa,

Lidhur me kërkesën tuaj të drejtuar Agjencisë kundër Korrupsionit, ju njoftojmë se; në kuadër të kompetencave të Agjencisë kundër Korrupsionit lidhur me konfliktin e interesit, sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (L.P.K.I), Agjencia; “*bënë këshillimin e zyrtarëve të lartë të veçantë, të eprorëve, të institucioneve eprorë, me kërkesën e tyre, për raste të caktuara të shfaqjes së konfliktit të interesave, dhe për çështje të etikës të lidhura me to, si dhe për regjistrimin rast për rast të interesave*”, (Neni 19 (paragrafi 1.5) i Ligjit nr.04/L-051), lidhur me kërkesën tuaj, Agjencia Kundër Korrupsionit ofron këtë:

**OPINION**

Agjencia Kundër Korrupsionit e ka trajtuar kërkesën për shqyrtimin e gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit, për znj. Sexhide Mustafa, pronar dhe person i autorizuar në kompaninë private Rima Group Sh.P.K, në rastin e aplikimit për grante në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë

dhe Zhvillimit Rural (Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë), me të cilën keni lidhje familjare (vajza).

Ndërsa, duke u bazuar në të dhënat e regjistrimit të këtij biznesi në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë, pronar i këtij biznesi është edhe znj. Fexhrije Mustafa me të cilën keni lidhje familjare (Gruaja), dhe person i autorizuar z. Mirsad Mustafa me të cilin keni lidhje familjare (djali).

Në nenin 6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit është paraparë nocioni i konfliktit të interesit i cili përcakton se “konflikti i interesit është gjendja e mospajtimit ndërmjet detyrës publike dhe interesave private të zyrtarit të lartë, kur ai ka interesa private të drejtpërdrejta ose të tërthorta, personale ose pasurore, të cilat ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në ligjshmërinë, transparencën, objektivitetin dhe paanësinë e tij gjatë ushtrimit të funksionit publik”.

Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit Nr.04/L-051, ka parapa kufizime, dhe ndalesa për zyrtarët e lartë, në situatë kur mund të ketë ose mund të shfaqet konflikti i interesit.

Po ashtu, në nenin 4 të këtij Ligji, janë të përcaktuar kategoria e zyrtarëve të lartë publik të cilët i nënshtrohen zbatimit të këtij Ligji.

Lidhur me pyetjen tuaj për gjendje të konfliktit të interesit në rastin kur vajza e juaj znj. Sexhide Mustafa do të aplikoj për grante në MBPZHR – Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, ju njoftojmë se Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit nuk ka përcaktuar ndonjë kufizim.

Neni 7 i Ligjit për PKI ka përcaktuar parimet e veprimit dhe mosveprimit të zyrtarit të lartë, të cilat janë:

“Zyrtari i lartë nuk duhet të lejoj që interesat e tij private të bien në konflikt me funksionin e tij. Ai duhet të shmang konfliktin e interesit pavarësisht nëse ai është real, apo i mundshëm”.

“Zyrtari i lartë nuk ka të drejt të shfrytëzojë funksionin publik për përfitim të kundërligjshëm për vete apo për të tjerët”.

“Zyrtari i lartë gjatë ushtrimit të funksionit publik nuk ka të drejt të krijojë marrëdhënie varësie nga persona tjerë që do të mund të ndikonin në paanshmërinë dhe shprehjen e vullnetit të lirë në vendimmarrje”.

“Zyrtari i lartë gjatë ushtrimit të funksionit publik duhet të veproj në mbrojtje të interesit publik dhe nuk ka të drejt që interesin e tij privat ta vërë para interesit publik, për mbrojtjen e të cilit është zgjedhur apo emëruar”.

Neni 9 i Ligjit për PKI ka përcaktuar veprimet e ndaluara të zyrtarit të lartë, në paragrafin (4,6,7,8,9), të këtij neni ndër të tjera thuhet se zyrtarit të lartë publik u ndalohen këto veprime:

“Të ndikojë në vendimin e ndonjë zyrtari apo organi për arsye të përfitimit material personal apo personit në lidhje me të”.

“Të ndikojë në marrëdhënie të punëve apo furnizimeve publike për përfitime personale”.

“Të shfrytëzojë informatat e besueshme që i ka në dispozicion apo të marra në mirëbesim në ushtrimin e funksionit për përfitime personale apo për përfitime të personave të afërt apo te besueshëm”.

“Të ndërmarr veprime të cilat në ndonjë mënyrë do t’i përshtaten interesit personal të tij apo interesit të personave të afërt apo te besueshëm”.

Zyrtari i lartë gjatë ushtrimit të funksionit publik gjithnjë duhet të ketë parasysh deklarin rast për rast të interesave private lidhur me ndonjë vendimmarrje të caktuar neni 13 (paragrafi 1,2,3).

Agjencia Kundër Korrupsionit u është mirënjohës për bashkëpunimin tuaj dhe ju inkurajon që të vazhdoni këtë edhe në të ardhmen.

Me respekt!